



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani Elezit

01/ Nr. 66/2011

Në bazë të nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimin Administrativ Nr.10/2010 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativë Nr.41/2006 të datës 27.12.2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, nenit 32.5 të Statutit të Komunës, nenit 15.2 të Rregullores së Punës së Kuvendit, shkresës përcjellëse me numër 01/Nr.66/2011 të datës 24.05.2011 nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari, dhe Zhvillim Rural, procesverbalin e komisionit për ndërrim destinim të pronës me numër 11-Nr.13/2011 të datës 24.05.2011, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit, në mbledhjen e mbajtur më datë: 30.06.2011 mori:

V E N D I M

PËR NDËRRIM DESTINIMI TË TOKËS BUJQËSORE

I

Me këtë Vendim LEJOHET ndërrim destinimi i përhershëm i tokës bujqësore në atë ndërtimore për pronarin z.Avni Reçi sipas kërkesës së tij.

II

Prona e lejuar bujqësore për ndërrim të destinimit ka sipërfaqe 200 m², dhe gjendet në parcelën kadastrale Nr.198/1 në vendin e quajtur "BREGU I BARDH" zona kadastrale Hani i Elezit, më kulturë arë e klasit të pestë (5), e evidentuar në emër të z. Avni Mefail Reçi, sipas fletës poseduese Nr.00400.

III

Pronari i palujtshmërisë në emër dhe interes të të cilit bëhet ndërrim destinimi nga toka bujqësore në tokë ndërtimore obligohet që pronën ta shfrytëzoj vetëm për qëllimin e caktuar (ndërtimi i shtëpisë për banim) e nuk mund të përdoret për qëllime të tjera.

IV

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit, ndërsa do të zbatohet pas pagesës së përcaktuar në bazë të Udhëzimit Administrativë Nr.10/2010 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativë Nr.41/2006 të datës 27.12.2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

V

Për Zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në bazë të ligjeve në fuqi.

VI

Më këtë Vendim njoftohen: Pala, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Këshilla juridike: pala e pa kënaqur ka drejtë të paraqes ankesë në Gjykatë në afat prej 8 (tetë) ditëve nga pranimi i këtij vendimi.

Hani i Elezit:
Data: 30.06.2011

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Menduh Vlasi

